



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI DREJTUES

Nr. 51 / prot
5

Tiranë më 28/09/2023

V E N D I M

Nr. 6 , datë 28.09.2023

PËR KRITERET E KUALIFIKIMIT PËR POZICIONET E REJA TË PUNËS NË ISKK

Në mbështetje të ligjit nr. 10242 , datë 25.02.2010, " Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit " , neni 11 gërma "ë" , si dhe "Kodit të Proceduarave Administrative të Republikës së Shqipërisë," Kreu I, " Akti Administrativ" në përfundim të mbledhjes Bordi Drejtues :

V E N D O S I

1. Shfuqizimin e kritereve të posaçme të punës për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Studimeve të miratura me vendimin Nr .1, datë 31.01.2023
2. Rimiratimin e kritereve të posaçme për pozicionin e punës së Drejtorit të Drejtorisë së Studimeve.
3. Miratimin e kritereve të posaçme të kualifikimit për pozicionet e tjera bashkangjitur këtij vendimi.

K R Y E T A R I

Uran BUTKA



KRITERET E PUNËS PËR PUNONJËSIT E RINJ

1. Pozicioni - DREJTOR I DREJTORISË SË STUDIMEVE

Kandidati duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të posaçme

- Të zotërojë minimalisht “Master Shkencor” në shkeca sociale dhe humane. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet vërtetimin e njohjes nga MASR.
- Të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune , 3 nga këto në pozicione drejtuese
- Të zotërojë në nivel mesatar gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK.
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.
- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 *PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI*

Përbëjnë avantazh:

- Studimet në fushën e historisë
- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojne të shkuarën komuniste.
- Njohuri të gjuhes anglese në nivelin C1
- Të zotërojë doktoraturë.
- Mesatare mbi 8.
- Individë që në portofolin e tyre kanë punime shkencore.

Krytari

Uran Butka

KRITERET E PUNËS PËR PUNONJËSIT E RINJ

Në Drejtorinë e Studimeve:

1. Pozicioni – Specialist-Studiues në Sektorin e Kerkimit Shkencor (dy)

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë çdo kandidat në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të posaçme:

- Të zotërojë minimalisht “Master Profesional” në shkeca sociale dhe humane.
- Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet unifikimi i diplomës nga MASR.
- Të ketë përvojë pune minimalisht 1 vit .
- Preferohet mesatare mbi 8.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.
- Të zotëroj gjuhën angleze në nivel mesatar.
- Të zotëroj njohuri kompjuterike

- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 *PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI*

Përbëjnë avantazh:

- Master Shkencor ose Doktoraturë në degën Histori.
- Botimet monografike, dokumentare ose artikuj studimore në revista me ISSN .
- Eksperiencia e punës në institucione universitare ose kërkimore.
- Pjesmarrja në Konferenca Shkencore
- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojne të shkuaren komuniste.
- Gjuha angleze ne nivel c1

2. Pozicioni – Specialist-Koordinator i Edukimit në Sektorin e Edukimit dhe Informimit Publik (një)

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë cdo kandidat në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të posaçme

- Të zotërojë minimalisht “Master Profesional” në shkeca sociale dhe humane. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet vertetimin e njohjes nga MASR.
- Të ketë përvojë pune minimalisht 1 vit në institucione arsimore.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK.
- Të ketë njohuri të politikave arsimore.
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.

- Të zotëroj gjuhën angleze në nivel mesatar.
- Të zotëroj njohuri kompjuterike
- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 *PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI*

Përbëjnë avantazh:

- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojne të shkuarën komuniste.
- Njohuri të gjuhes anglese në nivelin C1

KRYETARI

Uran BUTKA

